

LIGJI Nr. 03/L-192

## PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

## LIGJ PËR KËSHILLIN E PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

### DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

#### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbiqëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli).

#### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

- 1.1. **Nëpunës Civil** - anëtarët e Shërbimit Civil të përcaktuar me Ligjin për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës;
- 1.2. **Sekretariat** - organin i cili ndihmon Këshillin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tij.
- 1.3. **Kodi i Etikës** – Kodi i etikës të cilin e nxjerrë Këshilli.

#### **Neni 3**

#### **Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës**

Këshilli është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjidh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

#### **Neni 4**

#### **Përbërja e Këshillit**

1. Këshilli përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente.
2. Përbërja e Këshillit pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtar emërohen nga komunitetet joshqiptare dhe së paku dy (2) anëtar të jenë të gjinisë femërore.

#### **Neni 5**

#### **Kushtet për t'u zgjedhur anëtar i Këshillit**

1. Për tu zgjedhur anëtar i Këshillit kandidati duhet të ketë kualifikime dhe t'i plotësojë këto kushtet:

- 1.1. të jetë shtetas dhe banorë i përhershëm i Republikës së Kosovës;
- 1.2. të jetë me integritet të lartë moral;
- 1.3. të ketë së paku diplomë të fakultetit juridik apo administratë publike që është e vlefshme sipas ligjit në fuqi;
- 1.4. të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune në shërbimin civil;
- 1.5. të jetë njohës mirë i legjislacionit në fuqi;
- 1.6. të mos jetë i dënuar për vepër penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj.

#### **Neni 6 Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit**

1. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Këshillit apo pas shpalljes së vendit të lirë të punës për arsye të tjera, Kuvendi i Kosovës në pajtim me rregulloren e punës nxjerrë shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj.
2. Emërimet e propozuara që pranohen shqyrtohen nga një Komision ad –hoc i Kuvendit të Kosovës.
3. Brenda periudhës kohore prej njëzetënjë (21) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo vend të lirë të punës në Këshillë, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e Shërbimit Civil politikisht të paanshëm në Kosovë, që bazohet në merita dhe pasqyron karakterin shumetnik të Kosovës.
4. Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë.

#### **Neni 7 Mandati i anëtarëve të Këshillit**

1. Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat pesë (5) vjeçar, me mundësi rizgjedhjeje vetëm edhe për një mandat tjetër.
2. Anëtar i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër apo të merr pjesë aktive në aktivitete politike.

#### **Neni 8 Kryetari i Këshillit**

1. Kryetari i Këshillit zgjidhet nga radhët e anëtarëve të tij, me mandat dy (2) vjeçar.
2. Kryetari i Këshillit udhëheq punën dhe koordinon aktivitetet e anëtarëve të Këshillit.
3. Kryetari i Këshillit përfaqëson dhe përgjigjet për veprimtarin e Këshillit, jep autorizime për ushtrimin e detyrave, cakton komisione dhe nxjerr vendime.

#### **Neni 9 Shkarkimi i Anëtarëve të Këshillit**

1. Me propozimin e shumicës së anëtarëve të Këshillit, rekomandim të komisionit të përhershëm të Kuvendit apo përmes mocionit të Deputetëve, Kuvendi i Kosovës mund ta shkarkojë anëtarin e Këshillit me shumicë votash për shkak të arsyeve në vijim:

- 1.1. paaftësisë profesionale;
- 1.2. paaftësisë mentale apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit;
- 1.3. dënimit për vepër penale e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;
- 1.4. mungesës në punë mbi një (1) muaj për arsyet që nuk parashihen me ligj; dhe
- 1.5. shkeljes së paragrafit 2. të nenit 7 të këtij ligji dhe Shkeljes së kodit të Etikës.

#### **Neni 10 Funksionet e Këshillit**

1. Këshilli ka këto funksione:

- 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civilë kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e Shërbimit Civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;
- 1.2. vendos nëse emërimet e nëpunësve civil të nivelit drejtues janë bërë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës;
- 1.3. mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil.

#### **Neni 11 Kompetencat e Këshillit**

1. Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të tij Këshilli mund të:

- 1.1. vizitojë çdo vend ku janë të punësuar nëpunësit civilë;
- 1.2. ketë qasje dhe t'i kontrollojë të dhënat me shkrim lidhur me punësimin, emërimin, procedurat disiplinore dhe avancimin e nëpunësve civilë ose lidhur me shqyrtimin dhe vendimet për ankesa dhe
- 1.3. mund ta intervistojë çdo nëpunës civil, i cili mund të ketë informata që kanë rëndësi të drejtpërdrejtë për ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

2. Këshilli i jep paraprakisht zyrtarit të nivelit të lartë drejtues të organit përkatës të punësimit një njoftim të arsyeshëm për çfarëdo vizite apo kërkesë të informatave, duke cekur llojin e informatave të cilat i kërkon dhe nëpunësit civilë që kërkojnë për intervistë.

#### **Neni 12 Ankesat**

1. Nëpunësi civil i cili është i pa kënaqur me vendim të organit të punësimit, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, ka të drejtë të ankohet në Këshill.

2. Në emër të Këshillit ankesat i shqyrton dhe i vendos kolegji i përbërë nga tre (3) anëtarë të Këshillit.

3. Rregullat dhe procedurat për ankesa sipas këtij neni caktohen nga Këshilli. të cilat përcaktojnë:

- 3.1. që para parashtrimit të ankesës në Këshill, nëpunësi apo kandidati i cili pretendon se është dëmtuar duhet t'i ketë shteruar procedurat e brendshme të ankesave të organit përkatës të punësimit, përveç nëse Këshilli e përjashton këtë kërkesë për shkak të frikës së arsyeshme të hakmarrjes, dështimit të organit të punësimit për të zgjidhur ankesën brenda tridhjetë (30) ditësh ose për ndonjë shkak tjetër të arsyeshëm;

3.2. që pala e dëmtuar dhe organi i punësimit të kenë mundësi t'ia paraqesin me shkrim qëndrimet e tyre Këshillit, të cilat duhet t'i vihen në dispozicion palës kundërshtuese;

3.3. që në rastet e kontesteve të fakteve materiale, të dy palëve t'u jepet mundësia që së bashku të merren në pyetje nga Këshillit, ku ata mund t'i paraqesin provat dhe dëshmitë gjatë marrjes në pyetje dhe hetimit;

3.4. që për çdo ankesë që paraqitet para tij, Këshilli brenda afatit prej (60) ditësh pas përfundimit të procedurës së ankesës duhet të lëshojë një vendim me shkrim, duke arsyetuar vendimin e tij dhe bazën ligjore e faktike të atij vendimi.

3.5. përjashtim nga nën-paragrafi 3.4 i këtij paragrafi mund të ketë në rast kur natyra e lëndës është specifike për të cilin Këshilli nxjerr vendim dhe afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh mund ti shtohen edhe tridhjetë (30) ditë.

4. Në rastet kur Këshilli bindet se përmes vendimit të kundërshtuar janë shkelur parimet apo rregullat e Shërbimit Civil të Republikës së Kosovës, ai nxjerr vendim me shkrim i cili i drejtohet zyrtarit të nivelit të lartë drejtues apo përgjegjës kryesor të organit përkatës të punësimit, i cili është përgjegjës për zbatimin vendimit të Këshillit

5. Anëtari i Këshillit i cili ka marrë pjesë si anëtar i komisionit përkitazi me emërimin e një nëpunësi civil, nuk mund të marrë pjesë në procedurën e ankesës ndaj vendimit të tillë.

### **Neni 13 Vendimi i Këshillit**

Vendimi i Këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

### **Neni 14 E drejta e ankesës**

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të inicioj konflikt administrative në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit të Këshillit.

### **Neni 15 Procedura në rast mos zbatimi të vendimit të këshillit**

1. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës.

2. Nëse personi përgjegjës i institucionit nuk ekzekuton vendimin e Këshillit në afatin e paraparë me nenin 13 të këtij ligji, Këshilli në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, nga dita kur ka kaluar afati për ekzekutim, duhet të njofton me shkrim kryeministrin, dhe eporin e drejtpërdrejt të personit përgjegjës për ekzekutim.

3. Njoftimi nga paragrafi 2. i këtij neni konsiderohet kërkesë për fillimin e procedurës disiplinore dhe materiale kundër personit përgjegjës për ekzekutim, e cila zhvillohet në pajtim me dispozitat e parapara Ligjin për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

4. Brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të filloj procedurën e ekzekutimit në gjykatën komunale sipas ligjit për procedurën përmbaruese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Nëse gjykata kompetente vendos që punëtori (personi), i cili e ka kontestuar këtë mosekzekutim (mosekzekutimin e vendimit), t'ia kompensoi shumën e pagave, shpenzimet procedurale

dhe shpenzimet tjera të mundshme, personi përgjegjës i institucionit mban edhe përgjegjësi materiale për dëmin që ia ka shkaktuar institucionit sipas ligjit.

5. Këshilli duhet të njofton me shkrim Kuvendin e Republikës së Kosovës për vendimet që nuk janë ekzekutuar.

### **Neni 16** **Shqyrtimi i emërimeve të nëpunësve civilë**

1. Me qëllim të shqyrtimit të emërimeve të nëpunësve civil të nivelit drejtues, për të verifikuar nëse ato emërimet janë bërë në pajtim me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës, Këshilli:

1.1. përfaqësohet se paku nga një (1) anëtar i cili do të marrë pjesë si vëzhgues në mbledhjet e çdo komisioni të emëruar për shqyrtimin e punësimit apo avancimit të kandidatëve për plotësimin e posteve të nivelit drejtues;

1.2. pas rekomandimit të anëtarit të Këshillit që ka vepruar si vëzhgues, Këshilli vendos nëse vendimet e komisioneve të emërimit janë marrë në pajtim me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës dhe i rekomandon me shkrim organit të punësimit, nëse vendimet e komisioneve të emërimit nuk janë në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës.

2. Nëse organi punësimit nuk zbaton rekomandimin e cekur në nën-paragrafin 1.2. paragrafi 1. të këtij neni Këshilli njofton Kuvendin e Kosovës dhe Kryeministrin.

### **Neni 17** **Vlerësimi i respektimit**

1. Me qëllim që të vlerësohet respektimi i parimeve të parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës nga ana e organit të punësimit, në institucione, Këshilli për çdo vit:

1.1. shqyrton një mostër të të dhënave të punësimit që i mbajnë organet e punësimit;

1.2. vëzhgon drejtpërsëdrejti një mostër të procedurave të punësimit, të avancimit dhe të procedurave të tjera disiplinore të organit të punësimit; dhe

1.3. sipas nevojës, interviston personat e punëdhënësve që janë përgjegjës për vendimet e shqyrtuara nga Këshilli.

2. Në rastet kur Këshilli konstaton sferat që lypset korrigjuar, ai i bën rekomandime udhëheqësit kryesor ekzekutiv të autoritetit përkatës të punësimit.

3. Këshilli i vlerëson përgjigjet e organeve të punësimit të ofruara sipas rekomandimeve të Këshillit dhe aty ku një autoritet i punësimit pa arsye nuk i zbaton rekomandimet e tilla, Këshilli ia paraqet çështjen Kuvendit, i cili i'a përcjell Kryeministrin.

### **Neni 18** **Bashkëpunimi me organet e punësimit**

Këshilli bashkëpunon me organet e punësimit për t'i kryer funksionet e tij në përputhje me këtë ligj, dhe organet e punësimit janë të obliguara të bashkëpunojnë me Këshillin. Në rastet kur organi i punësimit nuk bashkëpunon, Këshilli i raporton për këtë mosbashkëpunim Kuvendit, i cili njoftimin ia përcjell eprorit të tij të drejtpërdrejtë, dhe Kryeministrin

### **Neni 19** **Raporti vjetor**

1. Këshilli i paraqet raport vjetor Kuvendit të Kosovës. Këshilli një kopje të raportit për informim ia përcjell Kryeministrit.

2. Raporti i Këshillit i vihet në dispozicion publikut pas aprovimit nga Kuvendi. Raporti botohet në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

#### **Neni 20 Sekretariati i Këshillit**

1. Në kuadër të këshillit funksion Sekretariati i tij, i cili ndihmon këshillin në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të këshillit.

2. Sekretariati udhëhiqet nga drejtori ekzekutiv i Sekretariatit i cili i përgjigjet drejtpërdrejtë Kryetarit të Këshillit. Drejtori dhe nëpunësit e sekretariatit janë nëpunës civil.

#### **Neni 21 Financimi i Këshillit**

1. Këshilli financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës. Këshilli ka vijën e vetë buxhetore e cila i garanton pavarësinë e tij.

2. Këshilli mund të marr kontribute nga donatorët dhe ato nuk duhet të ndikojnë në pavarësinë e Këshillit.

3. Për kontributet e donatorëve që pranohen njoftohet Kuvendi.

4. Niveli i pagës së kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit caktohet në pajtim me ligjin për pagat e zyrtareve të lartë.

#### **Neni 22 Rregullorja e punës së Këshillit dhe Kodi i Etikës**

Këshilli miraton Rregulloren e Punës dhe Kodin e Etikës

#### **Neni 23 Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut, Nr. 2008/12, për Ndryshimin e Rregullores Nr. 2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë.

#### **Neni 24 Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/ L-192  
15 korrik 2010**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-040-2010, datë 02.08.2010 nga Presidenti i Republikës së Kosovës,  
Dr. Fatmir Sejdiu.**